




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK.nr.466/2022

Datë: 02 dhjetor 2022

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 të Ligjit nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, në mbledhjen e jashtëzakonshme, të mbajtur me datë 2 dhjetor 2022, merr këtë:

V E N D I M

- I. Ndryshohet pjesërisht vendimi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës KGJK.nr.444/2022, i datës 23 nëntor 2022, në pikën II, III, IV dhe V, si në vijim:
 1. Nga data 3 dhjetor 2022 gjykatat vazhdojnë punën me kapacitete të plota.
 2. Pezullimi i bashkëpunimit për iniciativat e përbashkëta në mes të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës do të vazhdojnë deri në një vendim tjetër, ndërsa Këshilli Gjyqësor dhe gjykatat do të marrin pjesë në komisionet dhe grupet tjera ku pjesëmarrja përcaktohet me legjislacionin në fuqi.
 3. Mbetet në fuqi pika I e vendimit KGJK.nr.444/2022, me të cilin “Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Kryetarët e gjykatave, kërkojnë nga Qeveria e Republikës së Kosovës që menjëherë të anuloj vendimin nr.03/109, të datës 23 nëntor 2022”.
- II. Vendimi hyn në fuqi me datë 2 dhjetor 2022 dhe vlen deri në një vendim tjetër.

Albert ZOGAJ,
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës



Kopje e vendimit i dërgohet:

- Qeverisë së Republikës së Kosovës;
- Gjykatave të Republikës së Kosovës;
- Sekretariatit të KGJK-së, si dhe
- Arkivit.